

MARRËVESHJE FINANÇIMI KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, e përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Integrimit Evropian; në vijim të referuar bashkërisht si "Përfituesit e IPA II", ose veçmas si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1

Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin e lëvrimit për vitin 2016 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë për vitet 2015-2017
IPA/2016/038-163

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)¹.

2. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e lëvrimit për vitin 2016 të këtij Program Veprimi është 2,000,000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është vendosur 1.700.000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e IPA II.

¹ Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

Neni 2**Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional**

- (1) Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.
- (2) Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3**Adresat dhe Komunikimi**

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar dhe do të referohet shprehimisht Programit të Veprimtërisë siç identifikohet në nenin 1 (1), dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin

Drejtoria e Përgjithshme e Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit,
15, Rue de la Loi
B – 1049 Bruksel
Belgjikë
Drejtoria D, e-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA II

Sekretariati për Çështjet Evropiane,
Quai Dimitar Vlahov No.4,
1000 Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,
Tel: +389 (0)2 3200 105, Faks: +389(0)2 3114 569,
e-mail: cabinet@sep.gov.mk

Ministria e Integrimit Evropian
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Sheshi Nënë Tereza 1010
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel: +355 (0)4 228645
e-mail: info@integrimi.gov.al

Neni 4

Pikat e kontaktit të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të OLAF-it, do të jenë:

Snezana Petrovska, Shefe e Njesisë ", "Policia Financiare e Maqedonisë",
Quai Dimitar Vlahov floor 4 No.4,
1000 Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,
e-mail: suzana.petrovska@finpol.gov.mk

Ilir Meçe, Njësia e Inspektimit Financiar, Ministria e Financave,
Republika e Shqipërisë,
e-mail: Ilir.Mece@financa.gov.al

Neni 5

Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 24 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) që ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015, (referuar në vijim si "Marrëveshja/jet Kuadër").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 6

Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
 - a) këto Kushte të Veçanta;
 - b) Shtojca I: Programi i Veprimit të BNK-së, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë (Vendimi Zbatues i Komisionit C(2015) 5233 i datës 22.7.2015);

- c) Shtojca IA: IPA II CBC 2014-2020 Programi ndërmjet ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë;
- d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;
- e) Shtojca III: Raporti Vjetor Model CBC për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;
- f) Shtojca IIIA: Raporti Vjetor Tip për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;
2. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër, të dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA dhe dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti, ndërmjet dispozitave të Shtojcës I, nga njëra anë dhe dispozitave të Shtojcës IA, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi ditën që do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën angleze në tri kopje, një kopje i dorëzohet Komisionit dhe një kopje secilit prej përfituesve të IPA II.

Për përfituesit e IPA II:

Arbër Ademi,

Zëvendës Kryeministër për Çështjet Evropiane
dhe Koordinator Kombëtar i IPA-s

Shkup

Datë:

Klajda Gjasha,

Ministër i Integrimit Evropian dhe
Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Tiranë

Datë:

Për Komisionin:

Genoveva Ruiz Calavera

Drejtor pranë Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtoria D,

Bruksel

Datë:

